

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 432 Prot.

Tiranë, më 30.03 2017

VENDIM Nr. 48, datë 24.03.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 5 të datës 24.03.2017, pasi shqyrtoi Raportin e sondazheve arkeologjike në sitin, *Stacioni i Valvulave ABV 27, fshati Qafë, Potom rrethi Skrapar, të Linjës së Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP)*, realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k..

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e sondazheve arkeologjike në sitin, *Stacioni i Valvulave ABV 27, fshati Qafë, Potom rrethi Skrapar, të Linjës së Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP)*, realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Të vijojnë punimet e zbatimit për ndërtimin "Linja e Gazsjellësit TRANS ADRIATIK (TAP), Fushata e III (KM 69 - KM 139,674)", duke kryer ndjekjen në mënyrë periodike ditore të punimeve të gërmimit, sipas akt- marrëveshjes tre palëshe, e cila do të lidhet ndërmjet "TAP AG", shoqërisë së licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k. dhe ASHA, përcaktuar në pikën 3 të vendimit të KKA Nr. 40, datë 24.03.2017.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO